

QËNDRA E ZHVILLIMIT BULQIZË

Në Bulqizë më 26 Korrik u përrua një Qendër e re Zhvillimi për fëmijë me nevoja të vecanta Qendra është ndërtuar me ndihmën e PNUD-it në Shqipëri, në kuadër të Programit "Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri", të financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillimin dhe Bahkëpunimin dhe të zbatuar në partneritt me Qeverinë e Shqipërisë dhe Agjensitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Qendra mund të presë deri në njëzet e pesë fëmijë që kanë nevojë për terapi rehabilitimi dhe zhvillimi. Kjo qendër është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar dhe, për ata që përfitojnë shërbimet e qendrës, ofron dhe një mjedis që mundëson zhvillimin individual¹ dhe socializimin mes tyre

Qëllimi i kësaj qendre zhvillimi konsiston në ofrimin e shërbimeve cilësore të kujdesit shoqëror për fëmijët me aftësinë të kufizuar. Gjithashtu të përmissohen mundësitë për përfshirje sociale të fëmijëve me aftësi ndryshe në Bulqizë, dhe të përmissohen kapacitetet locale për ofrim shërbimesh cilësore dhe të qëndrueshme. Qendra ofron shërbime psiko-sociale për të mbështetur rehabilitimin, edukimin dhe rritjen e autonomisë së personave me aftësi të kufizuar me qëllim integrimin e tyre në shoqëri, si dhe ndihmon e bashkëpunon me familjet e tyre për të arritur këtë qëllim. Qendra duhet të ketë një ekip prej 5 profesionistësh por në kushtet aktuale kemi vetëm një Punonjëse Sociale një Fizioterapist logopede, psikologe dhe një sanitare.

Mjediset e Qendrës së Zhvillimit janë të rehabilituara. Hapësira e qendrës së Zhvillimit përfshin dy mjedise për terapi të zhvillimit në grup, dy mjedise për terapi zhvillimi individual, një dhomë për fizioterapi, një tjetër për terapi okupacionale, dhe mjedise të tjera ndihmëse.

Numri i fëmijëve që frekuentojnë Qendrën E Zhvillimit dhe marrin shërbime është 19 fëmijë të moshës nga 2-16 vjeç. Këto fëmijë vijnë në qendër në interval kohe të ndryshme që variojnë nga ora 8:00 deri në orën 16:00. . Aksesueshmëria në Qendrën e zhvillimit është për gjatë 12 muajve të vitit.

Cdo fëmijë që frekuenton qendrën ka dosjen personale të tij në të cilën gjenden formularë vleresimi, formularë nevojash, planë pune, plan i kujdesit, diagnoza dhe disa formulafë si formulari që jep informacion për nevojat e përgjithshme të fëmijës, procesverbali i incidetit të mbrotjes së PAK, formular i referimit të ankesave. Fëmijët e Qendrës së zhvillimit kanë diagnoza të ndryshme si prsh :

1. Çrregullime te spektrit te autizmit
2. Sindrome Down
3. Prapambetje e thelle mendore
4. Çrregullime ne sjellje
5. Vonese gjuhesore
6. Luxecacion I Artikulacionit Kokso-Femoral Bilateral
7. Veshtiresi ne te nxene
8. Paralize Cerebrale Spastike, Paraplegji Inferiore

Punonjësi Social dhe Fizioterapisti ndërhyjnë në fusha të ndryshme zhvillimi për fëmijët e Qendrës.

Fushat e vlerësimit të nevojave për secilin klient të pranuar në qendër janë:

1.Pavorsia praktike; ushqimi ,veshja, higjena e trupit ,sjellja sociale, qëndrimi në klasë.

2Psikomotorika: Motorika dhe eukulibri ,motorika e përpunuar , skema e trupit, ritmi, organizimi në hapsirë ,organizimi I kohës, grafizmi .

3 Zhvillimi I shqisave : Perceptimi I të parit, perceptimi I të prekurit, perceptimit I të shijuarit , perceptimi I të nuhaturit, perceptimi I të dëgjuarit .

4 Gjuha dhe komunikimi : Të folurit e kuptueshëm , të shprehurit verbal në mënyrë spontane, ,leximit , shkrimit, komunikimit jo verbal. Në këtë fushë lind nevoja dhe të një profesionisti tjetër si lokopedist.

5 Përafrimi shifrave dhe numrave : numërimi,bashkësitë dhe relacionet, përafrimi shifrave, operacionet, përdorimi I shifrave dhe numrave.

6 Aktivitetet në institucion : Qëndrimi në punë , aktivitete në qendër, puna riprodhuese.

Për sa i përket rolit të drejtpërdrejt të punonjësit social në përkujdesin të PAK janë:

-Indetifikojnë me aftësi të kufizuar që në moshë të hershme , të cilët kanë prapambetje mendore apo vështirësi në të mësuar,problem emotive,fizike apo apo në sjellje,dhe përcaktojnë shërbimet për të përmisuar aftësitë e tyre.

- Ndhimjnë prindërit të inetifikojnë programet për këtë kategori .

-Rekomandojnë mësuesit e edukimkit me parashkollorë për të ofruar kujdes individual që ata të

kapërcejnë vështirësitë.

- Punonjësi social ndjekin nevojat bazë të fëmijëve, organizojnë aktivitete që nxisin zhvillimin fizik ,emotive,intelektual dhe social të fëmijës.

Përdorimi i raportit të vlerësimit të nevojave.

· Raporti për Vlerësimin e Nevojave dhe Ecurisë (RVNE) është një dokument që shërben për të menduar, mbajtur shënime dhe për të analizuar nevojat dhe ecurinë e PAK.

· Ky raport ndihmon në praktikën e punës sociale profesionale. Plotësimi i tij është përgjegjësi e punonjësit social. Provat merren nga diskutimet me anëtarët e familjes të PAK kujdestarët dhe profesionistët e qendrës.

· Qëllimi i shqyrtimit të nevojave dhe ecurisë së PAK, shihet si pjesë thelbësore e procesit të Vlerësimit

· Çdo deklaram shoqërohet me një kuti Po dhe Jo me pjesën shënime dhe të dhëna të tjera. Punonjësit socialë duhet ta mbajnë shënime për vlerësimin e PAK nga profesionistët.

· Raporti për Vlerësimin e Nevojave dhe Ecurisë shërben si mjet për vlerësimin dhe planifikimin e shërbimeve.

· Me qëllim që të monitorohet ecuria e PAK, me kalimin e kohës, plotësohen vlerësimet e përmbledhura të progresit.

Vendodhja: Lagjia Minatori, Qyteti i Vjeter, Bulqize (prane kopshtit "Eleni Kola"
